



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11
30.04.2014

NR. VENDIMI 8
01.05.2014

V E N D I M
“PËR SEKUESTRIMIN E PASURISË”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e përbërë nga :

Gjyqtar : Klodian KURUSHI

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Ermira TERBUNI**, sot më datë **01. 05. 2014, ora 10: 00**, zhvilloi gjykimin e kërkesës penale që i perket;

KËRKUES : Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga **prokurori Besnik Muci**.

KUNDËR : **1. H.M.**, i biri i M. dhe i S., i datëlindjes xxx, lindur në xxx, xxx dhe banues në Rrugën “xxx”, pallati xxx xxx. Gjykimi u zhvilluar gjykimi në mungese të tij.

2. E.M., i biri i H. dhe i H., i datëlindjes xxx, lindur në xxx dhe banuës në Rrugën “xxx”, pallati xxx Tiranë. Gjykimi u zhvilluar në mungesë të tij.

OBJEKTI : **a) Sekuestrimin e pasurive të më poshtme:**
1. Llogaria me nr. xxx në Banken xxx, në emër të shtetasit H.M.M. në shumën xxx euro.

2. Llogaria me nr. x në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
3. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
4. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
5. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
6. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
7. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
8. Llogaria me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.

b) Per Administrimin e kësaj pasurie të ngarkohet z. K.Xh.,
i cili është administrator pranë Agjencisë për
Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të
Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, adminstroi provat, dëgjoi diskutimin përfundimtar të prokurorit i cili kërkoi:

Sekuestrimin e pasurive sipas objektit të kërkesës. Për administrimin dhe përdorimin e pasurive të ngarkohet z. **K.Xh.**, i cili është administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë si dhe për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbarimit xxx

V Ë R E N:

Prokuroria Për Krime të Rënda Tiranë me datë xxx ka regjistruar procedimin pasuror nr. xx të vitit xxx në ngarkim të shtetasve E.M., K.M. dhe H.M.

Në ngarkim të këtyre shtetasve më datë xxx nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësore xxx, ka filluar procedimi penal nr. xxx, i vitit xxx, pasi këta shtetas dyshohen të kenë kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, parashikuar nga neni 287 i K. Penal.

Nga hetimet e këtij procedimi rezulton se më datë xxx shtetasi K.M. është arrestuar në xxx për veprën penale të “Mbajtjes të lëndëve narkotike”. Shtetasi E.M. dhe H.M., përkatësisht vëllai dhe babai i shtetasit K.M., kanë depozituar në bankat shqiptare shuma të mëdha financiare të cilat dyshohet se kanë rrjedhur nga aktivitete kriminale dhe se depozitimi i këtyre shumave dyshohet se janë veprime me qëllim për të fshehur burimin e paligjshëm të tyre.

Në kuadër të hetimit penal gjykata e rrethit gjyqësor xxx, me vendimin nr. xxx datë xxx ka vendosur sekuestron preventive për të gjitha asetet financiare (shumat e parave), te shtetasve E.M. dhe H.M.

Gjykata referuar akteve përkatëse, konstaton në të tilla rrethana se shtetasit E.M., K.M. dhe H.M., dyshohet se kanë kryer veprën penale të “Pastrimit të produkteve të vepres penale” parashikuar si krim nga neni 278 i K.Penal dhe si të tillë ata janë subjekt i hetimit pasuror sipas ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, konkretisht sipas nenit 3/1 pikat “ç” dhe “d”, pasi këta shtetas rezultojnë të jenë persona nën hetim për veprat penale për të cilat është parashikuar fusha e zbatimit të këtij ligji.

Nga aktet e hetimit konkretisht sipas shkresës me nr.xxx datë xxx të Bankës xxx, shkresës me nr. xxx datë xxx të Bankës xxx, shkresës me nr. xxx datë xxx

të Bankës xxx, shkresës me nr. xxx datë xxx të Bankës xxx, si dhe procesverbalet për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, me vendimin nr. xxx datë xxx për vendosjen e sekuestros preventive të llogarive bankare rezulton se shtetasit E.M. dhe H.M. disponojnë ne këto banka llogaritë me shumat e mëposhtme:

1. Llogaria me nr. xxx në Banken xxx, në emër të shtetasit H.M.M. në shumën xxx euro.
2. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
3. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
4. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
5. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
6. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
7. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.
8. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx Euro.

Gjithashtu ka rezultuar se nga Prokuroria Për Krime të Renda Tiranë janë kryer verifikime lidhur me të ardhurat e shtetasve E.M., K.M. dhe H.M. dhe sipas pergjigjes se ardhur nga QKR me nr. xxx, datë xxx këta shtetas nuk figurojnë të regjistruar për ushtrimin e ndonje aktiviteti privat në regjistrin tregtar.

Në këto kushte shtetasit H.M. dhe E.M. nuk rezulton që të kenë të ardhura të tjera nga burimet e ligjshme për të justifikuar shumat e ndodhura në llogaritë bankare.

Nga faktet e mësipërme rezulton se pasuria në shumën totale prej xxx Euro është në pronësi të shtetasve nën hetim dhe i është gjetur atyre e depozituar në bankat e përmendura më lart. Çështja penale në ngarkim të shtetasve E.M. dhe H.M. është në perfundim të hetimit dhe me qëllim ruajtjen dhe administrimin e këtyre pasurive deri në gjykimin e kërkesës për vendosjen e masës së konfiskimit (nëse një kërkesë e tillë do të paraqitet nga prokuroria), mund të ekzistojë rreziku real dhe potencial se kjo pasuri e përshkruar më lart në likuiditete mund të tjetersohet dhe të humbasë. Për këtë qëllim është e nevojshme vendosja e masës së sekuestrimit në bazë të nenit 11/1/a të ligjit nr. 10192 datë 03. 12. 2009.

Nga sa më sipër rezultoi nga aktet e provat shkresore, sa vijon;
Vendim i datës xxx për regjistrimin e procedimit pasuror nr. x të vitit xxx, Informacion lidhur me procedimin penal nr. xxx të vitit xxx dërguar me shkresa nr. xxx datë xxx të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor xxx, Vendimi i gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx nr. xxx datë xxx për vendosjen e sekuestrimit preventiv të llogarive bankare dërguar me shkresën nr. xxx datë xxx të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx, Urdhri i datës xxx për regjistrimin e procedimit penal për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, Urdhri i datës xxx për regjistrimin e emrit të shtetasve E.M. dhe H.M. në regjistrin e veprave penale, Kërkesa për ndihmë juridike autoriteteve italiane me nr. xx datë xxx, aktet e zgjatjes së hetimeve, Materialet e referimit të çështjes penale në ngarkim të shtetasve K.H.M. (29 flete), Shkresa nr. xxx datë xxx e Unionit financiar Tiranë, Informacion i Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave (8 flete), Shkresa nr. xxx datë xxx të Bankës xxx, Shkresa nr. xxx, të Bankës xxx Shkresa nr. xxx datë xxx të Bankës xxx, Shkresa me nr. xxx datë xxx të Bankës xxx, Urdhri datë xxx për ekzekutimin e vendimit të caktimit të masës preventive së bashku me katër procesverbalet e ekzekutimit të Bankës xxx në Bankën xxx, në Bankën xxx dhe në bankën xxx, Shkresa nr. xxx datë xxx e QKR lidhur me shtetasit nën hetim dhe familjarët e tyre të paraqitura nga organi i prokurorisë në seancë gjyqësore.

Bazuar në rrethanat dhe prova të mësipërme, gjykata çmon se kërkesa e

prokurorisë për sekuestrimin e pasurive të kërkuara nga ana e saj gjendet e bazuar në ligj dhe do të pranohet, pasi personat që disponojnë këto pasuri, po hetohen për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të vepres penale” parashikuar si krim nga neni 278 i K. Penal dhe natyra e kësaj vepre penale krijon indicje të mbeshtetur në provat e përmendura më lart, se ato janë krijuar si rezultat i aktivitetit të paligjshëm në fushën transaksioneve që lidhen me pastrimin e produkteve të veprës penale.

Në përfundim të këtij gjykimi, gjykata konkludon se duke u bazuar në provat e shqyrtuara dhe të analizuara me lart, ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje se, personat ndaj të cilëve është paraqitur kërkesa për sekuestrimin e sendeve, dyshohet se janë përfshirë në veprimtari kriminale, nga ato që parashikon pika 1 e nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009. Ata zotërojnë pasuri të përshkruara më lart të cilat dyshohet se rrjedhin nga kjo veprimtari e kunderligjshme për të cilën ata po hetohen.

Nga provat e shqyrtuara gjykata çmon se ekziston një rrezik real për humbje, marrje, transferim apo tjetërsim të pasurive, ndaj të cilave mund të zbatohet në të ardhmen masa e konfiskimit, në qofte se këto pasuri nuk do të sekuestrroheshin nga kjo gjykate, në përputhje me procedurat e parashikuar nga ky ligj.

Sendet e kërkuara për sekuestrim janë gjithashtu të sekuestruara me kërkesë të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për llogari të procedimit penal të nisur prej saj ndaj këtyre personave. Bazuar në nenin 5/3 të ligjit 10 192 datë 03. 12. 2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masa Parandaluese kundër Pasurisë”.

Gjykata urdhëron pezullimin e pasojave të zbatimit të masës së sekuestros për sa kohë këto sende (likuiditete) qëndrojnë të sekuestruara me një vendim të marrë për llogari të një procedimi penal të nisur nga Prokuroria e rrethit gjyqësor xxx. Nëse në të ardhmen gjykata penale do të marrë një vendim penal për revokimin apo shuarjen e masave të sekuestros atëherë pezullimi i masës së sekuestros i dhënë në këtë vendim civil përfundon dhe sekuestrimi i sendeve rivendoset menjëherë sipas këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 3, 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimet të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

V E N D O S I

– Sekuestrimin e pasurive të mëposhtme:

1. Llogarinë me nr. xxx në Banken xxx, në emër të shtetasit H.M.M. në shumën xxx (xxx) euro.
2. Llogarinë me nr. xxx në Banken xxx ne emer të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro.
3. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro .
4. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro.
5. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro.
6. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro.
7. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. në shumën xxx (xxx) Euro.
8. Llogarinë me nr. xxx në Bankën xxx në emër të shtetasit E.H.M. ne shumën xxx (xxx) Euro.

b) Per Administrimin e kësaj **pasurie** të ngarkohet **z. K.Xh.**, i cili është administrator pranë Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

g) Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet Zyra e Përmbartimit xxx.

- Kundër vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes për palen e pranishme, ndersa për palët në mungese, ky afat fillon nga dita e marrjes

dijeni për vendimin.

U shpall në Tiranë më datë 01. 05. 2014.

SEKRETARE

Ermira TERBUNI

GJYQTARI

Klodian KURUSHI